



Nr. VII/1-140 Data 23/06/2020
Br. REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Direkcijaza Zdravstvo i Socijalno
Mirotvorno Departament for Health and Sociale Welfare**

Komuna e Obiliqit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të kompetencave të cilat dalin nga ligji nr.03/048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë rreth tyre, ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare nr.02/L-17, Statutit të Komunës së Obiliqit, nr.01/34, të datës 25.04.2016, konformë rregullores nr.108, të datës 25.11.2016, për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

Për blerjen dhe mbështetjen e këtyre shërbimeve të veçanta:

- I. Shërbime sociale dhe familjare për fëmijët pa përkujdesje prindërore
- II. Shërbime për personat me aftësi të kufizuar
- III. Shërbime për strehimin e viktimave të dhunës në familje
- IV. Shërbime për pensionist

Kushtet për konkurim:

1. Aplikacioni (mirret në zyrën pritëse,objekti komunal Obiliq).
2. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së. (OJQ-të aplikuese të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike - (për të dëshmuar këtë kërkesë, OJQ-ja aplikuese duhet të dërgoj kopjen e certifikatës së regjistrimit me rastin e aplikimit- Obligative).
3. Certifikatën e numrit fiskal, të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Me rastin e aplikimit OJQ- duhet të dëshmojë këtë kërkesë përmes kopjes së certifikatës së numrit fiskal- obligative.
4. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, i cili duhet të dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit të rezultateve përfundimtare (pas publikimit të rezultateve preliminare të përfituesve). (obligative)
5. Të ketë dorëzuar projekt propozimin. (obligative)
6. Të ketë dorëzuar propozimin e buxhetit. (obligative)
7. Licencën për shërbimin e kërkuar.

8. Të dorëzoj CV të menaxherit të projektit.
 9. Dokumenti identifikues- kopje
 10. Konfirmimin e xhirollogarisë bankare të OJQ-së
1. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 1,000.00€, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5,000.00€.
 2. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 14.07.2020 ora 15:00.
 3. OJQ-të mund të aplikojnë me një projekt në kuadër të kësaj thirrje. Periudha e zbatimit të projektit është për 12 muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën për të cilën aplikojnë.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në zyrën pritëse të Komunës së Obiliqit. (Rruga “Adem Jashari”).

Vërejtje: Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Obiliq, 23.06.2020

Dr. I DSHMS - së

